



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ____ / ____ / 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: Agjencia e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan adresa: Lagjja “Shkumbini”, Elbasan.

Drejtuar: “**G . A . C**” **sh.p.k.** me adresë: Rruga "Him Kolli", pallati i ri 2T, kati i parë, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-47615-10-27-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje ndriçuesish, me fond limit **25,000,000** (njëzet e pesëmilion) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Agjencise se Sherbimeve Publike, Bashkia Elbasan për vitin 2022, 2023 dhe vitin 2024 .Vlera e financimit për vitin 2022 do të jetë **8,333,333** (tetëmilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh.** Kohëzgjatja e kontratës 1 muaj nga nënshkrimi.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “G . A . C” sh.p.k. me Nipt: L61619031A

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **23,000,000** (njëzet e tremilion) **lekë (pa tvsh)**.

2. “ALBA LIGHT” sh.p.k. me Nipt: L41307038I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **19,800,770** (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqindmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) **lekë (pa tvsh)**.

3. “HEST” sh.p.k. me Nipt: L21527009H

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **20,019,400** (njëzetmilion e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind) **lekë (pa tvsh)**.

4. “NAIM 2020” sh.p.k. me Nipt: M02417012V

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **24,944,000** (njëzet e katërmilion e nëntëqind e dyzet e katër mijë) **lekë (pa tvsh)**.

5. “PAT POWER AUTOMATION & TEKNOLOGY” sh.p.k. me Nipt: L 41723018 R

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “PAT POWER AUTOMATION & TEKNOLOGY” sh.p.k. me Nipt: L 41723018 R s’kualifikohet për arsyet e mëposhtme:

Nuk keni paraqitur oferte ekonomike si dhe asnjë dokumentacion ligjor, ekonomik financiar dhe teknik.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

2. “NAIM 2020” sh.p.k. me Nipt: M02417012V s’kualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Nuk keni paraqitur sigurimin e ofertës duke mos përmbushur pikën 1 gërma b, të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertes, sipas shtojcës 1;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

2. Nuk keni paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit duke mos përmbushur pikën 1 gërma c, të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertes, sipas shtojcës 1;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

OE "Naim 2020" sh.p.k duke mos paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 nuk përmbush një pjesë të kriterëve të përgjithshme për kualifikim.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

3. OE nuk plotëson pikën 2.3.1. të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE "Naim 2020" sh.p.k nuk paraqitur asnjë dokumentacion (faturë tatimore apo vërtetim) për të vërtetuar se ka kryer furnizime të ngjashme për kontratën që prokurohet.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

4. OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të **disponojë nje automjet të përshtatëm për transport me kapacitet mbajtes minimalisht 3.5 ton**, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të tretë për automjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

OE "Naim 2020" sh.p.k nuk ka vetëdeklaruar/paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar se disponon nje automjet të përshtatëm për transport.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

5. OE nuk plotëson pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementët sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambjentet e Drejtorisë së Prokurimeve Publike, Bashkia Elbasan.

OE "Naim 2020" sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë nga mostrat e kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

6. OE nuk plotëson pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.5 Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori për mallin objekt prokurimi shoqëruar me katalogun/ët ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qartë specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

OE "Naïm 2020" sh.p.k nuk ka paraqitur autorizimin e kërkuar për mallin objekt prokurimi shoqëruar me katalogun/ët ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qartë specifikimet teknike të saj.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

3. "HEST" sh.p.k. me Nipt: L21527009H s'kualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. OE nuk plotëson pikën 2.3.1. të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm OE "Hest" sh.p.k ka paraqitur:

1. Vërtetim për realizim kontrate nr.842 prot. datë 26.03.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, sipas të cilit operatori ekonomik "Hest" sh.p.k. ka realizuar me sukses kontratën nr.560/15 prot. datë 23.04.2019 me objekt : "Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik" me vlerë totale 32,545,542 lekë me tvsh si dhe kontratën nr.2193/9 prot. datë 13.09.2019 me objekt: "Blerje materiale për ndriçim publik" me vlerë totale 27,140,520 lekë me tvsh.

2. Kontratën nr.2139/9 prot. datë 13.09.2019 me objekt: "Blerje materiale për ndriçim publik" me vlerë totale 27,140,520 lekë me tvsh lidhur midis OE "Hest" sh.p.k. dhe Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

3. Kontratën (marrëveshjen kuadër) nr.106/1 prot. datë 08.02.2021 lidhur midis OE "Hest" sh.p.k. dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë, shoqëruar me Vërtetim realizim kontrate me objekt: "Materiale elektrike" me vlerë totale 9,003,754 lekë me tvsh.

Kontratat e lidhura me Drejtorinë e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë nuk janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Njoftimi i shpalljes së kontratës është bërë në datë 28.10.2022, dhe si datë e fundit e realizimit të kontratës për të përmbushur kriterin e lartëpërmendur do të ishte data 28.10.2019, ndërkohë që kontratat e sipërcituara janë realizuar në muajin prill dhe shtator 2019.

Kontrata e lidhur me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë nuk përmbush vlerën e kërkuar për furnizime të ngjashme e cila është 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, e shprehur në vlerë absolute 10,000,000 milion lekë pa tvsh, ndërkohë që kontrata e sipërcituar është në vlerën 7,503,128 lekë pa tvsh.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

2.OE nuk plotëson pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementët sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambjentet e Drejtorisë së Prokurimeve Publike, Bashkia Elbasan.

OE "Hest" sh.p.k ka paraqitur mostrat e kërkuara jo në përputhje me specifikimet teknike e konkretisht:

1. Mostra me emërtimin Baraban (zgjatues) 3x2.5=25ml, është paraqitur jo në përputhje me specifikimet teknike pasi kabëlli nuk është 3x2.5 por 3x1.5.

2. Mostrat me emërtimin ndriçues LED me krah 100 Ë dhe ndriçues LED me krah 60 Ë nuk kanë të përshkruar jetëgjatësinë duke e bërë të pamundur krahasimin me specifikimet teknike.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

3.OE nuk plotëson pikën 2.3. të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.5 Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori për mallin objekt prokurimi shoqëruar me katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qartë specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

1. OE ka paraqitur skedën teknike për produktin kabëll 3x2.5 mm². Të dhënat teknike për këtë produkt nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor e konkretisht: a) spesori mesatar i mbështjelljes së përcaktuar tek specifikimet teknike është 1.8mm, ndërsa ai i paraqitur tek skeda teknike është 1.2mm; b) pesha e kabllit së përcaktuar tek specifikimet teknike është 220 g/m, ndërsa pesha e paraqitur tek skeda teknike është 180g/m.

2. OE ka paraqitur skedën teknike për produktin ndriçues LED me krah 60Ë dhe 100Ë. Të dhënat teknike për këtë produkt nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor e konkretisht: a) IP (izolacioni) tek specifikimet teknike është IP67, ndërsa IP e paraqitur tek skeda teknike është IP66; b) jetëgjatësia tek specifikimet teknike është mbi 60.000 orë, ndërsa jetëgjatësia e paraqitur tek skeda teknike është 40.000 orë; c) CRI tek specifikimet teknike është mbi 90, ndërsa CRI e paraqitur tek skeda teknike është 80.

3. OE nuk ka paraqitur katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve për produktin Baraban (zgjatues) 3x2.5.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se:

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. “ALBA LIGHT” sh.p.k. me Nipt: L41307038I s’kualifikohet për arsyet e mëposhtme:

OE nuk plotëson pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të DST ku parashikohet :

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementët sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambientet e Drejtorisë së Prokurimeve Publike, Bashkia Elbasan.

OE "ALBA LIGHT" sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë nga mostrat e kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“G . A . C” sh.p.k. me Nipt: L61619031A**, me adresë: Rruga "Him Kolli", pallati i ri 2T, kati i parë, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **23,000,000** (njëzet e tremilion) **lekë (pa tvsh)** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencia e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan adresa: Lagjja “Shkumbini”, Elbasan sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO ☐ JO ☐

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Drejtori i Përgjithshëm i ASHP
Edvin Palloshi